M2



NË FAQE 18
**MUZIKË**
Elina Duni, rikthimi i *Dallëndyshes* në shtëpi



NË FAQE 14
**KULTURË**
Hi dhe gjak, si e duan francezët Kadarenë




NË FAQE 23
**BLOG**
Korrektesa politike në luftë me historinë

# Europa dhe dyshimet e saj

**Jean Domique Giuliani shkruan për sfidat e mëdha me të cilat përballet Europa dhe sidomos ajo e sigurisë. Europa ka dekada që e ka menduar të paprekshme sigurinë, por nuk është kështu.**

Me siguri, në muajt që vijnë, Europa duhet të përballojë sfida të shumta.

E para ndër to, sigurla e saj. Asnjëherë, që nga viti 1950, nuk ka qenë kaq e cenuar. Ne kishim harruar se, si banore e botës, Europa nuk do të dinte t'u shmangej zhvillimeve të rëndësishme gjeopolitike. Dhe kishim menduar se paqja e vendosur sërish te ne do të shtrihej natyrshëm te fqinjët tanë dhe më gjerë.

Për një kohë të gjatë, kështu ka qenë. Por jo më. Konfliktet, terrorizmi, ndërhyrjet ushtarake, refugjatët, mure dhe barriera, jo stabilitet dhe pasiguri ekonomike, e kthejnë Europën në realitetin e vështirë të një bote të goditur nga tronditje marramendëse.

Po a duhet, megjithatë, të ushqehet ky raport i çuditshëm ekzistencial me dyshimin, që karakterizon europianët?

Përpara këtyre zhvillimeve, janë të shumtë në numër ata që vënë gjithçka në pikëpyetje, madje edhe arritjet e pakundërshtueshme të Bashkimit Europian. Të shumtë janë gjithashtu ata që, të nxitur nga bindje fisnike, mjaftohen me pohimin se duhet "më shumë Europë", pa saktësuar se ku dhe si.

Asnjëra palë nuk duket e besueshme për opinionet europiane, që do të donin të ishin krenarë për këtë histori sidoqoftë të bukur.

Ajo që është risi në Europë, është kthimi i dyshimit në kontinentin e Dekartit. I mprehur nga rivalët tanë, ai përmbush lehtësinë dhe karakterin imitues të elitave të lodhura. Disa janë specialistë të vjetër të tij, si francezët, disa të tjerë shfrytëzues oportunistë si britanikët, të tjerë janë vëzhgues pasivë por utilitaristë.

Sepse është e vërtetë që integrimi europian duhet të provojë çdo ditë dobishmërinë e tij, dhe tani e tutje, të tregojë kontributin e tij për drejtuesit, mendja e të cilëve është ngatërruar nga dinamika, nga kompleksiteti i ndryshimit, dhe kërcënimi ndaj sigurisë.




Dyshimi është vlerë pozitive kur të shtyn të përmirësohesh, të shpikësh zgjidhje të reja me anë të imagjinatës, krijueshmërisë dhe konkretes. Dyshimi është vlerë negative kur të shtyn në pesimizëm, dhe në "dorëzim". Ndërmjet dy gjendjeve, puna e përditshme, e vështirë dhe pranë qytetarëve, e frymëzuar nga bindje të forta, të dala nga reflektimi strategjik afatgjatë, është rruga e vetme në përputhje me interesin e përgjithshëm. Atë të kombeve tona dhe të njeriut europian.

Është detyra e Bashkimit Europian në vitin 2016.

Në këtë vit të rëndësishëm, ai duhet të përshtatet me këtë prioritet absolut dhe për të arritur këtë duhet të përpiqet të dalë nga sfera brukseliane. Aktorët e tij, duke filluar nga qeveritë kombëtare, duhet t'u dalin për zot zgjedhjeve të tyre kolektive europiane, të rritin përpjekjet në fushën e mbrojtjes dhe të përforcojnë bashkëpunimin në Europë. Bëhet fjalë për sigurinë e saj.

Çdo mbyllje kombëtare do të ishte diçka kriminale dhe çmimi jashtëzakonisht i lartë.

Para këtyre sfidave të reja, nuk ka më vend për dyshim për atë çka jemi, për atë çka kemi arritur dhe për aftësitë tona për t'ia dalë. Mbetet vullneti...

Vit të mbarë 2016!

**President i Fondacionit Robert Schuman Paris*